



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.129

10 shtator

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.516, datë 6.7.2011	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në ngastrat e ekonomive pyjore Fag dhe Kërrabë Gurrë, Tiranë, që do të përdoren nga shoqëria “Hydro Energy”, sh.p.k., për ndërtimin e hec-ve “Murdhari 1 dhe 2” 5783
Vendim i KM nr.562, datë 3.8.2011	Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia..... 5786
Vendim i KM nr.564, datë 3.8.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Shutri” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.. 5786
Vendim i KM nr.565, datë 3.8.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Quku nr.1” e “Quku nr.2” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 5787
Vendim i KM nr.566, datë 3.8.2011	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve.... 5787
Vendim i KM nr.567, datë 3.8.2011	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010, për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore” 5788
Vendim i KM nr.568, datë 3.8.2011	Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme, gjimnazi franko-shqiptar “Ernest Koliqi” 5790

Vendim i KM nr.571, datë 3.8.2011	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	5791
Vendim i KM nr.576, datë 10.8.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2011 - 2012”.....	5792
Udhëzim i MASH dhe MF nr.29/1, datë 16.8.2011	Për “Përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”.....	5793
Udhëzim i MASH nr.31, datë 4.8.2011	Për vitin shkollor 2011–2012 në sistemin arsimor parauniversitar.....	5795

VENDIM
Nr.516, datë 6.7.2011

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË NGASTRAT
E EKONOMIVE PYJORE FAG DHE KËRRABË GURRË, TIRANË, QË DO TË
PËRDOREN NGA SHOQËRIA “HYDRO ENERGY”, SHPK, PËR NDËRTIMIN E HEC-VE
“MURDHARI 1 DHE 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja në ngastrat 70/b, 71/a, 71/c, 116/c, 117/c, 122/a të ekonomisë pyjore Fag, Tiranë, 27.55 (njëzet e shtatë pikë pesëdhjetë e pesë) ha, që do të përdoret nga shoqëria “Hydro Energy”, sh.p.k., për rezervuar dhe digë, si dhe sipërfaqja në ngastrat 53/a, 56/d, të ekonomisë pyjore Kërrabë Gurrë, Tiranë, prej 1.9 (një pikë nëntë) ha, që do të përdoret për ndërtimin e hidrocentraleve “Murdhari 1 dhe 2”, gjithsej 29.45 (njëzet e nëntë pikë dyzet e pesë) ha, të hiqen nga fondi pyjor e kullor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor e kullor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në sipërfaqe ujore (rezervuari) e truall për ndërtim HEC-i, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” dhe vendimit nr.1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

3. Të përfundojë procedura e pagesës për sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullor, që do të përdoret prej shoqërisë “Hydro Energy”, sh.p.k., në bazë të lidhjes nr.4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, “Hydro Energy”, sh.p.k., brenda 3 (tre) viteve, me fondet e veta, të pyllëzojë 10 (dhjetë) ha me pyje, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore.

Lloji i drurëve që do të mbillen dhe grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhë me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komunat Bërzhitë dhe Kërrabë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1

SIPËRFAQET QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR SIPAS PËRDORIMIT TË TERRITORIT DHE PRONËSISË

Nr.	Ekonomia pyjore/kullosore	Ngastra	Sip.ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor	Tipi i grumbullit	Pronësia
A.	Rezervuari							
1	EP Fag	70/b	4.627	Pyll	Cungishte	Prodhues	Dushqe të thjeshta	K/Bërzhitë
2	EP Fag	71/a	1.250	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shkozë e thjeshtë	K/Bërzhitë
3	EP Fag	71/c	8.550	E pafrytshme	-	-	-	K/Bërzhitë
4	EP Fag	116/c	8.500	E pafrytshme	-	-	-	Shtetërore
5	EP Fag	117/c	1.500	E pafrytshme	-	-	-	Shtetërore
6	EP Fag	122/a	3.125	Pyll	Cungishte	Prodhues	Dushqe të thjeshta	Shtetërore
	Shuma 1		27.552					
B.	Ndërtimi i HEC-eve							
1	EP Krrabë-Gurrë	53/a	0.050	Pyll	Shkurre	Prodhues	Mare e përzier	Shtetërore
2	EP Krrabë-Gurrë	56/d	1.850	Kullotë	Kullotë	-	-	K/Krrabë
	Shuma 2		1.900					
	TOTALI		29.452					



HYDROCENTRALET MURDZHAN I & 2

ГРУП: I	СЪСТАВ: 1	ОБЪЕМ: 1	СТАТУС: А
СЪСТАВ: II	СЪСТАВ: 2	ОБЪЕМ: 2	СТАТУС: Б
СЪСТАВ: III	СЪСТАВ: 3	ОБЪЕМ: 3	СТАТУС: В
СЪСТАВ: IV	СЪСТАВ: 4	ОБЪЕМ: 4	СТАТУС: Г
СЪСТАВ: V	СЪСТАВ: 5	ОБЪЕМ: 5	СТАТУС: Д
СЪСТАВ: VI	СЪСТАВ: 6	ОБЪЕМ: 6	СТАТУС: Е
СЪСТАВ: VII	СЪСТАВ: 7	ОБЪЕМ: 7	СТАТУС: Ж
СЪСТАВ: VIII	СЪСТАВ: 8	ОБЪЕМ: 8	СТАТУС: З
СЪСТАВ: IX	СЪСТАВ: 9	ОБЪЕМ: 9	СТАТУС: И
СЪСТАВ: X	СЪСТАВ: 10	ОБЪЕМ: 10	СТАТУС: К
СЪСТАВ: XI	СЪСТАВ: 11	ОБЪЕМ: 11	СТАТУС: Л
СЪСТАВ: XII	СЪСТАВ: 12	ОБЪЕМ: 12	СТАТУС: М
СЪСТАВ: XIII	СЪСТАВ: 13	ОБЪЕМ: 13	СТАТУС: Н
СЪСТАВ: XIV	СЪСТАВ: 14	ОБЪЕМ: 14	СТАТУС: О
СЪСТАВ: XV	СЪСТАВ: 15	ОБЪЕМ: 15	СТАТУС: П
СЪСТАВ: XVI	СЪСТАВ: 16	ОБЪЕМ: 16	СТАТУС: Р
СЪСТАВ: XVII	СЪСТАВ: 17	ОБЪЕМ: 17	СТАТУС: С
СЪСТАВ: XVIII	СЪСТАВ: 18	ОБЪЕМ: 18	СТАТУС: Т
СЪСТАВ: XIX	СЪСТАВ: 19	ОБЪЕМ: 19	СТАТУС: У
СЪСТАВ: XX	СЪСТАВ: 20	ОБЪЕМ: 20	СТАТУС: Ф
СЪСТАВ: XXI	СЪСТАВ: 21	ОБЪЕМ: 21	СТАТУС: Х
СЪСТАВ: XXII	СЪСТАВ: 22	ОБЪЕМ: 22	СТАТУС: Ц
СЪСТАВ: XXIII	СЪСТАВ: 23	ОБЪЕМ: 23	СТАТУС: Ч
СЪСТАВ: XXIV	СЪСТАВ: 24	ОБЪЕМ: 24	СТАТУС: Ш
СЪСТАВ: XXV	СЪСТАВ: 25	ОБЪЕМ: 25	СТАТУС: Щ
СЪСТАВ: XXVI	СЪСТАВ: 26	ОБЪЕМ: 26	СТАТУС: Ъ
СЪСТАВ: XXVII	СЪСТАВ: 27	ОБЪЕМ: 27	СТАТУС: Ы
СЪСТАВ: XXVIII	СЪСТАВ: 28	ОБЪЕМ: 28	СТАТУС: Ь
СЪСТАВ: XXIX	СЪСТАВ: 29	ОБЪЕМ: 29	СТАТУС: Я
СЪСТАВ: XXX	СЪСТАВ: 30	ОБЪЕМ: 30	СТАТУС: А

VENDIM
Nr.562, datë 3.8.2011

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPANËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10355, datë 2.12.2010 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli bazë i së ardhurës nga papunësia të jetë 6 850 (gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në grupin 25, titull 10550, kap.1, art.606 “Transferta të buxhetit familjar dhe invalidët” (E ardhura nga papunësia).
 3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Vendimi nr.697, datë 18.8.2010 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.564, datë 3.8.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SHUTRI” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3/b e 23, pika 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Shutri” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërive “Pashkashesh” sh.p.k., dhe “Arlita B” sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Shutri”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.565, datë 3.8.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “QUKU NR.1” E “QUKU NR.2” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3/b e 23 pika 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Quku nr.1” dhe “Quku nr.2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Di-Stafa” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Quku nr.1” dhe “Quku nr.2”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.566, datë 3.8.2011

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSUAR INDIVIDUALE, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2010	1.00;
Për vitin 2009	1.01;
Për vitin 2008	1.04;
Për vitin 2007	1.11;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2011 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.850, datë 21.10.2010 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.567, datë 3.8.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004, 2008, 2010, PËR PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010, për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2004, 2008, 2010 PËR PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë.

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshje.

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

duke ju referuar notës verbale 471/04 të datës 21 dhjetor 2004 dhe protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 7 tetor 2008 dhe të datës 18 maj 2010.

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat e mëposhtme për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”:

1. Një hua me vleftë prej gjithsej deri në 3 400 000 euro (me fjalë tre milionë e katërqind mijë euro) nga premtimi i vitit 2004, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit me vleftë prej gjithsej deri në 1 000 000 euro (me fjalë një milionë euro) nga premtimi i vitit 2010.

3. Disa shuma financimi me vleftë prej gjithsej 7 400 000 euro (me fjalë shtatë milionë e katërqind mijë euro) për projektin, me

a) deri në 3 000 000 euro (me fjalë tre milionë euro) nga premtimi i vitit 2008;

b) deri në 4 400 000 euro (me fjalë katër milionë e katërqind mijë euro) nga premtimi i vitit 2010.

Kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4) Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikë 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u

nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pikë 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2012. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1 pika 3a, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016. Për shumat e përmendura në nenin 1, paragraf 1 pikat 2 dhe 3b, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 19 korrik 2011 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.568, datë 3.8.2011

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME “GJIMNAZI FRANKO- SHQIPTAR “ERNEST KOLIQI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Gjimnazi franko-shqiptar “Ernest Koliqi”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.571, datë 3.8.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT
TË VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si më poshtë vijon:

a) Në programin e trashëgimisë kulturore, për vitin 2011, të pakësohet fondi me vlerë 2 159 446 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë, në zërin “Paga” dhe fondi me vlerë 1 589 674 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në zërin “Sigurime shoqërore”.

b) Në programin e artit dhe kulturës, për vitin 2011, të shtohet fondi me vlerë 2 159 446 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë, në zërin “Paga” dhe fondi me vlerë 1 589 674 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në zërin “Sigurime shoqërore”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.576, datë 10.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.423, DATË 8.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI EDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2011- 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2011 – 2012, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, janë 25 363, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë | 24 643; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 200; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 300; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 220.”. |

2. Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----------|
| “a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 25 143;”. |
|--|-----------|

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Kandidatët që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin e ri akademik 2011 – 2012, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si: personat që nuk shikojnë/personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.”.

4. Në fund të tabelës 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet programi i studimit sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

A	B	C	D	E	F	G
K-Universiteti	K-ID-Dega	K-Emërtimi-dega	Kuota prog.parë studentë shqiptarë	Kuota nga trojet	Tarifa prog.parë 2011-2012 (në lekë)	Tarifa prog.dytë 2011-2012 (në lekë)
Universiteti "E.Çabej" Gjirokastër	292	Histori dhe gjuhë italiane	60	0	12,760	120.664

UDHËZIM

Nr.29/1, datë 16.8.2011

PËR "PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË"

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, të nenit 61 dhe nenit 62 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 14 të vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifa për shërbimet që kryhen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhim të ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, për vlerësimin paraprak të programeve të studimit të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifa-ekspert vendas	Tarifa-ekspertizë e huaj në distancë	Tarifa-ekspertizë e huaj-prezent
a) vlerësim, paraprak i një programi të ri studimi dy-vjeçar jouniversitar	188,000	323,000	508,000
b) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të parë	193,000	338,000	589,000
c) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të dytë	204,000	533,000	659,000
ç) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të tretë	209,000	611,000	715,000

2. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet		Tarifat
a)	Vlerësimi i jashtëm dhe akredimi institucional i institucionit të arsimit të lartë/filial (ose akreditimi i parë) 1. Një institucion me 1-2 fakultete, filial ose kolegji 2. Një universitet me 3-5 fakultete ose filial me 3-5 fakultete	1,128,000 1,965,000
b)	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të parë 1. Me angazhim të ekspertëve vendas 2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	288,000 578,000
c)	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të dytë 1. Me angazhim të ekspertëve vendas	304,000

	2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	632,000
ç)	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të tretë	
	1. Me angazhim të ekspertëve vendas	320,000
	2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	646,000

3. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhim të ekspertëve për shërbime që nuk përfshihen në pikat 1 dhe 2, si për riorganizimin, ristrukturimin apo shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njësive të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifat
1. Vlerësimi i aplikimit për riorganizimin e programeve të studimit	93,000
2. Vlerësimi i aplikimit për ristrukturimin e institucionit	93,000
3. Vlerësimi i kërkesës për hapjen e një njësie në institucionet e arsimit të lartë	93,000
4. Konsulenca të Agjencisë të Akreditimit të Arsimit të Lartë që nuk përfshihen në kategoritë e lartëpërmendura	93,000

4. Kur pas vlerësimit paraprak në varësi të pikës 1 të këtij udhëzimi (pikat a-ç) ose pas vlerësimit të jashtëm, në varësi të pikës 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç), Këshilli i Akreditimit ose Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, respektivisht sipas kompetencave, vendos kushte për vlerësimin paraprak përfundimtar apo për akreditimin përfundimtar pozitiv dhe nëse institucionit i duhet t'i nënshtrohet sërish procesit të vlerësimit paraprak apo vlerësimit të jashtëm, subjekti paguan sërish por vetëm 35% të tarifës të përcaktuar në varësi të pikave 1 dhe 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç).

5. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 1 të këtij udhëzimi arkëtohet para fillimit të procesit të vlerësimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

6. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, arkëtohet para fillimit të procesit të aplikimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

7. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë shpërndahen 10% në Buxhetin e Shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë.

8. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 06, "Të ardhurat jashtë limitit".

9. Të ardhurat që sigurohen nga këto shërbime për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë përdoren si më poshtë:

a) për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, dhe konsulentëve, të cilët janë kontraktuar nga APAAL;

b) për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Këshillit të Akreditimit;

c) për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare;

ç) për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe shpenzimet e tjera të tij;

10. Institucionet e arsimit të lartë të cilët kanë aplikuar për shërbimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi dhe nuk kanë paguar tarifën e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 18.1.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", do të paguajnë tarifën e përcaktuar në këtë udhëzim.

11. Udhëzimi i përbashkët nr.2, datë 18.1.2011 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", shfuqizohet.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.31, datë 4.8.2011

PËR VITIN SHKOLLOR 2011- 2012 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË VITIN SHKOLLOR 2011-2012

Gjatë vitit mësimor 2011-2012 të punohet me strukturën dhe planet mësimore në vijim:

1. ARSIMI BAZË

Klasa	Mësim			Festa
	Sem. I	Sem. II	Gjithsej	
I - IX	18 javë	17 javë	35 javë	7 ditë

Mësim:

Semestri i parë fillon më 12 shtator 2011 dhe mbaron më 27 janar 2012;

Semestri i dytë fillon më 30 janar 2012 dhe mbaron më 6 qershor 2012.

Pushime:

Periudha e parë fillon më 24 dhjetor 2011 dhe mbaron më 4 janar 2012;

Periudha e dytë fillon më 28 mars 2012 dhe mbaron më 1 prill 2012.

Provimet e Lirimit zhvillohen në periudhën 7 - 22 qershor 2012.

2. ARSIMI I MESËM

a) Gjimnazi

Klasa	Mësim	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X-XI	36 javë	-	7 ditë
XII	34 javë	5 javë	7 ditë

b) Shkollat e mesme artistike 3-vjeçare dhe koreografike

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Provime: Matura Shtetërore	Festa
X - XI	34 javë	2 javë	-	7 ditë
XII	34 javë	-	5 javë	7 ditë

c) Shkollat e mesme artistike 4-vjeçare

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Festa
X-XI-XII	34 javë	2 javë	7 ditë

d) Shkollat e mesme sportive

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Takime Sportive	Festa
X	34 javë	2 javë	3 javë	7 ditë
XI	32 javë	4 javë	4 javë	7 ditë
XII	32 javë	4 javë	4 javë	7 ditë

Shënim 1

- Klasa XIII në vitin shkollor 2011-2012 do të vazhdojë me strukturën e vjetër.
- Mësimi fillon më 12 shtator 2011 dhe mbaron më 13 qershor 2012.
- Për maturat mësimi fillon më 12 shtator 2011 dhe mbaron më 22 maj 2012.

Pushime:

- Periudha e parë fillon më 24 dhjetor 2011 dhe mbaron më 4 janar 2012.
- Periudha e dytë fillon më 28 mars 2012 dhe mbaron më 1 prill 2012.
- Provimet e Maturës Shtetërore: 23 maj – 30 qershor 2012.

Shënim 2

- Lëndët e kulturës së përgjithshme janë të përbashkëta për të njëjtën strukturë në të gjitha shkollat.

- Praktikatat profesionale të vlerësohen me notë dhe kredite.

- Provimet e formimit teorik artistik/sportiv dhe specialiteti të vlerësohen me nota dhe këto nota të mos përfshihen në mesataren e përgjithshme.

Shënim 3

- Llogaritja e krediteve dhe e pikëve për shkollat artistike dhe sportive bëhet si në gjimnazin me kohë të plotë (Të gjitha lëndët kanë koeficientin 1)

e) Arsimi profesional

- Struktura (2+1+1)

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të nivelit	Festa
X	36 javë	36 javë	-	7 ditë
XI	34 javë	34 javë	2 javë	7 ditë
XII	34 javë	34 javë	2 javë	7 ditë

- Struktura 2+2

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të nivelit	Festa
X	36 javë	36 javë	-	7 ditë
XI	34 javë	34 javë	2 javë	7 ditë
XII	36 javë	36 javë		7 ditë

- Struktura 4 vjet bllok

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të nivelit	Festa
X-XII	36 javë	36 javë	-	7 ditë
XIII	34 javë	34 javë	-	7 ditë

Shënim 1

- Klasa XIII në vitin shkollor 2011-2012 të vazhdojë me strukturën e vjetër.
- Mësimi fillon më 12 shtator 2011 dhe mbaron më 13 qershor 2012.
- Për maturat mësimi fillon më 12 shtator 2011 dhe mbaron më 22 maj 2012.

Pushime:

- Periudha e parë fillon më 24 dhjetor 2011 dhe mbaron më 4 janar 2012.
- Periudha e dytë fillon më 28 mars 2012 dhe mbaron më 1 prill 2012.
- Sesioni i provimeve të teorisë dhe praktikës profesionale të integruar për nivelin I dhe II fillon më 1 qershor 2012 dhe përfundon më 15 qershor 2012.

- Provimet e Maturës Shtetërore: 23 maj – 30 qershor 2012.

Shënim 2

- Në vitin shkollor 2011-2012, klasat X dhe XI të shkollave profesionale do të punojë me skeletkurrikulat e nivelit I (2-vjeçar).

- Klasa XII të punojë me skeletkurrikulat e nivelit II (për strukturën 2+1+1) dhe të nivelit III (për strukturat 2+2 dhe bllok 4 vjet).

- Lëndët e kulturës së përgjithshme janë të përbashkëta për të njëjtën strukturë në të gjitha drejtimet dhe profilet mësimore të shkollave profesionale.

- Për profilin “Instalues hidrosanitar”, shkollat të punojnë me skletkurrikulën e përgatitur me mbështetjen e specialistëve të programit ALBVET. Drejtoritë e shkollave dhe departamentet e lëndëve profesionale, të përgatisin kurrikulin përkatës të klasës XII (profili i përzgjedhur).

Shënime të tjera

- Gjatë vitit shkollor 2011-2012 testimi i drejtuesve të organizohet sipas rregullores nr.7170/1, datë 22.11.2010 “Për kualifikimin e drejtuesve të institucioneve arsimore”.

- Në fillim të vitit shkollor 2011-2012 zbatohet rregullorja për “Organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”. DAR/ZA-të të marrin masat për të organizuar të gjithë procesin.

KREU II BAZA NËNLIGJORE

Veprimtaria e institucioneve të arsimit parauniversitar të mbështetet në të gjitha urdhrat dhe udhëzimet që janë në fuqi. Në mënyrë të veçantë:

- Në udhëzimin nr.21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Në rregulloren nr.2264/1, datë 5.4.2010 “Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar”.

- Në udhëzimin nr.22, datë 29.7.2010 “Për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar”.

- Në udhëzimin nr.37, datë 22.11.2010 “Për pranimet në shkollat e mesme të përgjithshme me kohë të shkurtuar dhe me korrespondencë, organizimin dhe njëvlershmërinë e tyre”.

- Në udhëzimin nr.23, datë 30.7.2010 “Për njëvlershmërinë e studimeve në shkollat e mesme me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar, në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

- Në udhëzimin nr.9, datë 25.2.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore”.

- Në urdhrin nr.326, datë 22.6.2010 “Për hapjen e drejtimit mësimor “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, në disa shkolla të mesme profesionale”.

- Në rregulloren nr. 4998, datë 27.7.2010 “Për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz”.

- Në udhëzimin nr.27, datë 9.6.2011 për “Vlerësimin e nxënësve me notë dhe kredite”.

Në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve përfundimtare të nivelit I dhe II të arsimit profesional”, datë 15.2.2011.

- Në udhëzimin nr.27, datë 26.7.2011 “Për masat për zhvillimin e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2011”.

- Në planet mësimore që përmban shtojca e këtij udhëzimi.
- Shënim. Të zbatohen:
 - Udhëzuesi “Për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit”, dhjetor 2010.
 - Shkresa nr.2966/1, datë 22.6.2011 për “Trajtimin e nxënësve me 20-50% të mungesave me arsye në shkollën e mesme”.
 - Shkresa nr.3346, datë 14.6.2011 “Sqarim për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar”.

KREU III
DISPOZITË TRANSITORE PËR NXËNËSIT MBETËS NË KLASËN E XII
(VITI SHKOLLOR 2010-2011)

Nxënësi që është mbetës në klasën e XII dhe e përsërit atë në vitin shkollor 2011 - 2012, i mbart kreditet si më poshtë:

1. Kurrikula bërthamë

Në tabelën më poshtë janë lëndët që nxënësi ka zhvilluar në klasën e X dhe XI dhe që do të njihen si lëndë të kurrikulës bërthamë (me kreditet për çdo lëndë):

Nr.	Lënda	Kreditet, klasa X	Kredite, klasa XI		
			Natyror	Shoqëror	Përgjithshëm
1	Biologji	2	2	2	2
2	Fizikë	2	2	2	2
3	Edukimi fizik	2	1	1	1
4	Gjeografi	2	1	1	1
5	Gjuhë e huaj e parë	2	3	3	3
6	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3	3	3	3
7	Histori	2	2	2	2
8	Kimi	2	2	2	2
9	Matematikë	3	3	3	3
10	Njohuri për shoqërinë	2	-	2	-
11	Teknologji	1	1	-	1
12	TIK	2	2	2	2
	Gjithsej	25	22	23	22

Shënime.

a) Lënda “Gjeografi 10” është e njëvlershme me lëndën “Shkenca e tokës” në kurrikulën e re.

b) Lënda “Njohuri për shoqërinë 10” është e njëvlershme me lëndën “Qytetaria 10” në kurrikulën e re.

c) Në mënyrë që nxënësi të plotësojë lëndët e kurrikulës bërthamë, duhet të japë provim jo më vonë se fundi i muajit nëntor 2011 dhe të fitojë:

- Për klasën X:
 - një kredit nga fusha e arteve.
 - një kredit nga fusha e aftësisimit për jetën dhe karrierën.
- Për klasën XI:
 - një kredit nga fusha e arteve (me përjashtim të nxënësve të profilit shoqëror).
 - një kredit nga fusha e aftësisimit për jetën dhe karrierën.

Kur nxënësi nuk fiton të paktën një nga këto kredite riprovohet deri më 22 maj 2012. Nëse përsëri nxënësi nuk fiton të paktën një kredit, nuk futet në Maturën Shtetërore 2012 dhe i mundësohet futja në të, vetëm pasi të ketë shlyer këtë detyrim.

2. Kurrikula me zgjedhje

a) Kur nxënësi ka pasur lëndë me zgjedhje në klasën e X, atij i njihet kjo lëndë në kurrikulën me zgjedhje të detyruar me 2 kredite.

b) Kur nxënësi nuk ka pasur lëndë me zgjedhje, atij i njihet “Teknologjia” me dy kredite, si lëndë me zgjedhje të detyruar.

- c) Për klasën e X, i njihet përforcim në “Matematikë” (1 kredit).
 - d) Nxënësit, sipas preferencës së tij, i njihen dy përforcime ndër lëndët e klasës së XI, ku është kalues, duke siguruar 2 kredite për kurrikulën me zgjedhje të lirë.
 - e) Nxënësve të profilit natyror ose të përgjithshëm u llogariten:
 - Dy kredite, nivel i avancuar në lëndën e matematikës së klasës së XI.
 - Dy kredite, nivel i zbatuar në lëndën e fizikës së klasës së XI.
 - f) Nxënësve të profilit shoqëror u llogariten:
 - Dy kredite, nivel i avancuar në lëndën e letërsisë.
 - Një kredit, nivel i avancuar në lëndën e historisë.
- Shënim. Në klasën XII, nxënësi duhet të realizojë 30 kredite.
- Krahas kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje, shkolla t’i krijojë kushte nxënësit të realizojë përgjatë klasës XII:
- ½ kredit për shërbim komunitar.
 - 1 kredit për module profesionale.

KREU IV PROGRAMET DHE TEKSTET MËSIMORE NË ARSIMIN PARASHKOLLOR DHE NË ARSIMIN BAZË

1. Arsimi parashkollor

Në zbatim të objektivit të MASH-it për të siguruar të paktën një vit përgatitor për fëmijët 5-vjeçarë, përfshirë fëmijët romë, egjiptianë dhe nga shtresa të marginalizuara, në vitin e ri shkollor të hapen 200 klasa të reja përgatitore. MASH mbështetur nga CBA dhe UNICEF do të sigurojë pajisjen me orëndi, bazë materiale didaktike dhe metodike si dhe trajnimin e mësuesve të klasave përgatitore. DAR/ZA të sigurojnë personelin mësimor brenda numrit ekzistues të fuqisë mësimore duke shfrytëzuar të gjitha rezervat e mundshme që kanë e në veçanti ato që krijohen nga ulja në total e numrit të nxënësve në klasën e parë si dhe të marrin të gjitha masat për përgatitjen e mjediseve të shkollave ku do të hapen klasat përgatitore.

2. Arsimi bazë

Në klasat I-IX të arsimit bazë:

- Në klasën e nëntë, të zhvillohet moduli “Edukimi për karrierën”, për t’u lehtësuar nxënësve orientimin e tyre për vijimin e arsimit të mesëm.

3. Arsimi i mesëm

3.1 Gjimnazi me kohë të plotë

- DAR/ZA-të dhe drejtuesit e gjimnazeve të kërkojnë zbatimin me rigorozitet të kurrikulës së re në klasën e XII, pa hequr vëmendjen nga kurrikula e klasës së X dhe të XI.

3.2 Gjimnazet me orientim gjuhësor

- Gjimnazet me orientim gjuhësor: “Kristo Isak” Berat; “Mahmut Ali Cungu” Elbasan; “Pandeli Sotiri” Gjirokastër; “Faik Konica” Korçë; “Shejnaze Juka” Shkodër dhe “Asim Vokshi” Tiranë të punojnë me planin e ri mësimor nr.1023, datë 17.2.2011, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës (shih shtojca 1).

- Klasat e X, e XI dhe e XII të gjimnazeve me orientim gjuhësor të punojnë me programet e reja të miratuara nga MASH-i.

- Për lëndën gjuhë e huaj të punohet me grupe në mbështetje të udhëzimit nr.21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

3.3 Seksionet shkollore dygjuhëshe

- Seksionet shkollore dygjuhëshe të funksionojnë sipas dokumenteve të nënshkruara si vijon:
- Seksionet shkollore dygjuhëshe shqiptaro-italiane funksionojnë në mbështetje të Memorandumit të Mirëkuptimit midis MASH dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë “Mbi funksionimin e seksioneve shkollore dygjuhëshe shqiptaro-italiane”, nënshkruar më 14 janar 2011, si dhe adendumit të këtij memorandumi, nënshkruar më 7.7.2011.

- Seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze të funksionojnë në mbështetje të marrëveshjes administrative midis MASH-it dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Europiane të Republikës së Francës, nënshkruar më 13 tetor 2010.

- Seksioni dygjuhësh shqiptaro-gjerman të vijojë funksionimin në mbështetje të memorandumit të mirëkuptimit midis MASH-it dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë për hapjen e seksionit dygjuhësh shqiptaro-gjerman, 14 prill 2009, dhe të deklaratave të bashkëpunimit për elemente të caktuara të seksionit.

- Plani mësimor, programet dhe tekstet e zgjedhura që zbatohen në tri seksionet dygjuhëshe janë bashkëlidhur me dokumentet e nënshkrimit. Në gjuhën shqipe të përdoren tekstet e miratuara në katalogun "ALTERTEKS 2012".

- Klasat e 11-ta dhe të 12-ta të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane dhe shqiptaro-franceze të punojnë me planet mësimore miratuar më 2009 dhe programet mësimore të përgatitura për to. Programet për lëndët në italisht dhe frëngjisht të jenë ato që janë përgatitur nga ambasadat përkatëse në mbështetje të memorandumit dhe konventës së mëparshme.

- Koeficientët e lëndëve për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman janë të miratuara me deklaratën e përbashkët për përcaktimin e koeficienteve dhe përshtatjen e planit mësimor në seksionin shqiptaro-gjerman në gjimnazin "Sami Frashëri.

- Koeficientët e lëndëve për seksionin dygjuhësh shqiptaro-italian janë të miratuara me adendumin për ndryshimet në planin mësimor dhe shkollat, nënshkruar më 7.7.2011.

4. Gjuhët e huaja në arsimin parauniversitar

4.1 MASH, në lidhje me gjuhët e huaja në sistemin parauniversitar, udhëzon:

a) Marrjen e masave për mbulimin, me çdo kusht, me gjuhë të huaj të shkollave të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm që nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaj deri në vitin e kaluar shkollor. DAR/ZA – të të raportojnë brenda datës 9 shtator për realizimin e kësaj detyre.

b) Marrjen e masave që drejtoritë e shkollave në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm, për asnjë arsye, të mos krijojnë pengesa në vijimësinë e gjuhës së huaj të parë të nisur nga klasa III ose VI deri në përfundim të arsimit të mesëm dhe të gjuhës së huaj të dytë, e nisur në klasën VI dhe e dokumentuar në dëftesën e lirimimit.

c) Marrjen e masave që shkollat e arsimit parauniversitar, pjesë e programit "Iliria", të vijojnë zbatimin e këtij programi duke mos reduktuar numrin e nxënësve që mësojnë gjuhën italiane si gjuhë e huaj e parë.

4.2 Për nxënësit e klasës XI dhe XII të cilët nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaj gjatë shkollimit të tyre, të sigurohet me përparësi mësimi i gjuhës së huaj si vijon:

a) Të gjitha orët e gjuhës së huaj të parashikuara në kurrikulën bërthamë dhe ato me zgjedhje të detyruar të vihen në dispozicion, duke mundësuar 5 orë gjuhë të huaj në javë (3 orë konsiderohen për kurrikulën bërthamë dhe 2 orë për atë me zgjedhje).

b) Mësimi të zhvillohet me programet dhe tekstet e gjuhës së huaj të dytë të gjimnazit, për nivelin fillestar.

c) DAR/ZA-të në bashkëpunim me vullnetarët e Korpusit të Paqes në rrethin e tyre do të përgatisin një plan pune për t'u mundësuar nxënësve kurse të veçanta 3 herë në javë jashtë procesit mësimor.

d) DAR/ZA-të të njoftojnë në MASH deri në datën 9.9.2011, në Drejtorinë e Edukimit Parauniversitar, sigurimin e studimit të gjuhës së huaj për nxënësit e klasës XI dhe XII të cilët nuk kanë zhvilluar asnjë gjuhë të huaj gjatë shkollimit të tyre.

KREU V

STRATEGJI, POLITIKA, PROGRAME DHE PROJEKTE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

1. Shërbimi psikologjik shkollor

1.1 DAR/ZA-të të marrin të gjitha masat që:

a) në fillim të vitit të ri shkollor të kenë zëvendësuar të gjithë psikologët që nuk kanë arsim përkatës, sipas udhëzimit nr.18, datë 21.4.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”;

b) të sigurojnë kabinetin e shërbimit psikologjik dhe pajisjen e tij në të gjitha shkollat që ofrojnë këtë shërbim;

c) të ngrihet, në çdo shkollë ku funksionon shërbimi, grupi i mbështetjes së psikologut;

d) të planifikohet dhe të realizohet raporti i veprimtarisë gjithëvjetore i shërbimit psikologjik në shkollë.

2. Zbatimi i planit për reduktimin në zero të braktisjes shkollore

2.1 Realizimi i këtij aksioni mbështetet nga “Plani i veprimit për reduktimin në zero të braktisjes shkollore 2009-2013”. Për uljen e treguesve të braktisjes shkollore, DAR/ZA-të të marrin këto masa:

a) Të ndiqet me përparësi arsimimi i nxënësve të ngjuar sipas udhëzimit të MASH-it nr.9, datë 11.4.2007 “Për arsimimin e nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”.

b) Të ndiqet me përparësi zbatimi i udhëzimit të MASH-it nr.34, datë 8.12.2004 “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë” për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”.

c) Të raportohet në MASH dy herë në vit (në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit shkollor) për realizimin e këtij plani, sipas formatit përkatës.

d) Të vazhdojë trajnimi i mësuesve që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën, ose që shfaqin prirje për braktisjen e saj.

e) Të hartohen programe të veçanta pune në nivel klase dhe shkolle për ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit.

3. Zbatimi i programit kombëtar COMBI “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive”

3.1 DAR/ZA-të, drejtoritë e shkollave dhe kopshtet të marrin masa për të planifikuar në planet vjetore:

a) ngritjen e strukturës së realizimit të programit dhe përcaktimin e personave përgjegjës.

b) hartimin e planit të aktiviteteve gjithëvjetore sipas programit COMBI.

4. Zbatimi i strategjive ndërministrore

4.1 MASH është pjesë e hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare ndërministrore të Qeverisë Shqiptare, si:

a) Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom si dhe plani i veprimit të dekadës romë;

b) Strategjia kombëtare për personat me aftësi të kufizuar;

c) Strategjia “Për riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer 2010-2015”;

d) Strategjia kombëtare antitrafik 2011-2013;

e) Plani i ri kombëtar për ushqimin dhe ushqyerjen;

f) Strategjia për edukimin për sigurinë rrugore;

g) Strategjia për luftën kundër përdorimit të drogës dhe alkoolit;

4.2 DAR/ZA-të, sipas udhëzimeve të dhëna nga MASH-i:

a) të caktojnë një person përgjegjës për ndjekjen e këtyre strategjive;

b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra konkrete, sipas planit të aktiviteteve të çdo strategjie;

c) të monitorojnë zbatimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji në nivel shkolle dhe në nivel DAR/ZA-je;

d) të raportojnë në MASH, në përfundim të çdo semestri, për veprimtaritë dhe për të dhëna statistikore për çdo strategji.

4.3 Për realizimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji, MASH-i, DAR/ZA-të dhe shkollat, të bashkëpunojnë edhe me OJF-të e specializuara dhe të interesuara në këto fusha. Bashkëpunimi të mbështetet në marrëveshje, memorandume dhe projekte dy- ose shumëpalëshe, të nënshkruara ose miratuara domosdoshmërisht nga MASH-i.

KREU VI VEPRIMTARI EDUKATIVE

1. Në qendër të vëmendjes, gjatë planifikimit të punës edukative të shkollës dhe të klasave, të jenë:

- a) Hartimi me përparësi i planit të aktiviteteve edukative, projekteve kurikulare dhe veprimtarive ekstrakurrikulare, në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.
- b) Përkujtimi i festave kombëtare dhe të ditëve të traditës.
- c) Tema të ndryshme që lidhen me integrimin evropian të vendit tonë: pasurimi i njohurive rreth institucioneve bazë të BE-së, edukimi ndërkulturor dhe shumëkulturor etj.
- d) Veprimtari ndërgjegjësuere për Ditën e Romëve, Ditën e aftësisë së kufizuar dhe autizmit, Ditën e barazisë gjinore, Ditën e luftës kundër dhunës, duhanit, alkoolit, SIDA-s etj.
- e) Organizimi dhe menaxhimi i fazave përgatitore dhe fazës finale të olimpiadave kombëtare në lëndët “Matematikë”, “Fizikë”, “Kimi”, “Biologji” dhe “Informatikë”. Të gjitha olimpiadat të realizohen në përputhje me rregulloren nr.2264/1, datë 5.4.2010 “Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar”.
- f) Veprimtaritë gjithëvjetore në fushën e gjuhëve të huaja në kuadrin e 10-vjetorit të Ditës Europiane të Gjuhëve.
- g) Në nivel DAR/ZA-je dhe shkolle, të planifikohen veprimtari kulturore – sportive.
- h) Planifikimi i veprimtarive intensive gjithëvjetore për edukimin për karrierën veçanërisht me nxënësit e klasës së 9-të dhe nxënësit e klasës së 12-të për ti informuar rreth mundësive të mëtejshme të shkollimit.

KREU VII ROLI DHE DETYRAT E STRUKTURAVE INSPEKTUESE

1. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP), sipas një plani aktiviteteve të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, gjatë vitit mësimor 2001-2012 të ketë si përparësi inspektimin:

- a) e zbatimit të kurrikulës XII të gjimnazit;
 - b) e procesit të përzgjedhjes së altertektit dhe shpërndarjes së librit shkollor;
 - c) e provimeve të lirimimit dhe të Maturës Shtetërore;
 - d) e procesit të pajisjes së bibliotekave shkollore me literaturë artistike, shkencore dhe didaktike;
 - e) e DAR/ZA-ve;
 - f) e arsimit profesional;
 - g) e arsimit privat parauniversitar;
 - h) e gjimnazit me kohë të shkurtuar (korrespondencë);
 - i) e zbatimit të ligjshmërisë në institucionet e arsimit parauniversitar;
 - j) e efektivitetit të përdorimit të laboratorëve të informatikës dhe atyre shkencorë të siguruara nga programi CBA (fizikë, kimi, biologji);
 - k) e cilësisë së mësimdhënies/nxënies së lëndëve shoqërore;
 - l) e edukimit shoqëror, artistik dhe sportiv në shkolla.
2. IKAP të pajisë me materiale profesionale (udhëzues të vlerësimit të kopshteve, të shkollave dhe të DAR/ZA-ve) të gjitha DAR/ZA-të.

KREU VIII TRAJNIMET

1. Të realizohen veprimtaritë trajnuese të parashikuara në programin CBA.
2. Mësuesit e informatikës:
 - të kryejnë trajnimin e ofruar nga MASH-i, me synim aftësimin e tyre për mësimdhënien/nxënien e lëndës së informatikës;

- të nxisin përfshirjen e teknologjisë së informacionit në lëndët e tjera, duke asistuar kolegët e këtyre lëndëve në përdorimin e laptopëve dhe videoprojektorëve për mësimdhënie.

3. IZHA të dërgojë në DEPU, brenda datës 20 shtator, planin vjetor të trajnimeve sipas cikleve dhe lëndëve.

4. Gjatë muajit shtator 2011, DAR/ZA-të të organizojnë dhe të menaxhojnë procesin e trajnimit të mësuesve të klasave XI dhe XII për zbatimin e kurrikulës së re.

5. Në vazhdimësi të organizohen trajnime me drejtues të shkollave, psikologët dhe koordinorët në DAR/ZA për luftën kundër përdorimit të drogave dhe alkoolin, për sigurinë rrugore dhe për njohuritë e azhuruara për BE dhe integrimin evropian.

Shënim.

AKP, në bashkëpunim me DAR/ZA-të dhe shkollat, të sigurojë përgatitjet për mbarëvajtjen në pjesëmarrjen në PISA-n 2012. Për këtë:

- Të hartojë një plan me detyra të përcaktuara për ecurinë e veprimtarisë;

- Të organizohen trajnimet me mësuesit për metodologjinë që përdoret në këtë lloj testimi.

KREU IX

REGJISTRIMET DHE PAJISJA E NXËNËSVE ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në shkollat e arsimit parauniversitar të fillojnë më datën 1.9.2011 dhe të mbyllen në datën 1.9.2011.

2. DAR/ZA-të, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të sigurojnë regjistrimin e nxënësve në përshtatje me vendbanimin e tyre.

3. Regjistrimi i nxënësve që kanë ardhur nga zona të tjera, të bëhet me fletëshpërngulje dhe fletëpranimi, të cilat do të evidentohen me rigorozitet në balancimin e kontigjentit të nxënësve.

4. DAR/ZA-të, sipas afateve të përcaktuara në formularin operativ “Lëvizja dhe balancimi i kontingjenteve të nxënësve” dhe detyrimeve për reduktimin në zero të braktisjes shkollore, të dërgojnë në MASH të dhënat mbi lëvizjet e nxënësve të arsimit bazë.

5. DAR/ZA-të të marrin masa që:

a) Në çdo shkollë të sigurohen të paktën dy mjedise për shpërndarjen e librit shkollor nga shtëpitë botuese, librat e të cilave janë përzgjedhur nga shkolla dhe janë në katalogun albertekst 2012.

b) Drejtoritë e shkollave të kontrollojnë furnizimin e mjediseve të shkollave vetëm me librat sipas kërkesës së tyre. Drejtori i shkollës mban përgjegjësi për rastet e shitjes në mjediset e shkollës të librave pa hologramë dhe që nuk figurojnë në katalogun “Albertekst - 2011”.

c) Drejtoritë e shkollave të monitorojnë pajisjen e nxënësve me tekstet shkollore dhe të informojnë DAR/ZA-të për ecurinë e procesit.

d) DAR/ZA-të të njoftojnë zyrtarisht Komisionin e Miratimit të Teksteve (KMT) në MASH për ecurinë e procesit të furnizimit të nxënësve me tekste shkollore si dhe problematikat e mundshme (mungesë tekstesh, shitje librash jashtë katalogut, shitje pa faturë etj.).

e) Drejtoritë e shkollave të fillojnë punën qysh në ditët e para të fillimit të vitit shkollor për zbatimin e udhëzimit të përbashkët të MASH-it dhe Ministrisë së Financave nr.15, datë 28.5.2010 “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen:

1. Të gjitha drejtoritë përkatëse në MASH, IZHA, IKAP, AKAFP, AKP, DAR-të, ZA-të dhe shkollat.

DAR/ZA-të të marrin masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo shkollë dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

SHTOJCA 1
PLANE MËSIMORE

ARSIMIT BAZË

Nr.	LËNDA									
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
1	Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)	8	8	6	5	5	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	-	-	2	2	2	2	2	3	3
3	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
4	Dituri natyre	-	-	2	3	2				
5	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
6	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
7	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
8	Vendlindje	-	-	-	-	2	-	-	-	-
9	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
10	Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
11	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
12	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
13	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	2	2	2
14	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
15	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
16	Informatikë							1	1	1
17	Veprimtari jashtëkurrikulare e lëndë me zgjedhje	1	1	1	2	2	2	1	1	1
18	Edukimi për karrierën	-	-	-	-	-	-	-	-	1*
	Shuma (orë/javë)	20	20	22	23	23	27	29	29	30

PAKICAT KOMBËTARE

Nr.	LËNDA	K L A S A T								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
01.	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	8/7	6	5	4	4	4	4	4	3
02.	Gjuhë shqipe dhe lexim letrar	0/2	5	5	5	5	4	4	4	4
03.	Gjuhë e huaj	-	-	-	-	-	2	2	2	2
04	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
05.	Dituri natyre	-	-	2	3	2	-	-	-	-
06.	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
07.	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
08.	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
09.	Vendlindja					2				
10.	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
11.	Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
12.	Histori amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	-	1
13.	Gjeografi amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	1	-
14.	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
15.	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
16.	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	1	1	2
17.	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
18.	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
19.	Veprimtari jashtëkurrikulare e lëndë me zgjedhje	1	1	1	1	1	1	1	1	1
20	Informatikë	-	-	-	-	-	-	1	1	1
21	Edukimi për karrierën	-	-	-	-	-	-	-	-	1*
	Shuma (orë/javë)	20/21	23	24	24	24	29	31	31	31

* Edukimi për karrierën me 17 orë të zhvillohet në semestrin e parë.

Orët javore të tipit 8/7 dhe të tjera të shprehura në këtë formë në disa lëndë tregojnë: shifra e parë është sasia e orëve për semestrin e parë dhe shifra e dytë është sasia e orëve për semestrin e dytë.

GJIMNAZI

a) Kurrikula bërthamë

Nr.	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Arte (muzika, vallëzimi, teatri, arti pamor) Histori arti	1	1	1
2	Edukimi fizik dhe sportet	2	1	-
3	Gjuha e huaj e parë	3	3	4
4	Gjuha shqipe dhe letërsia	3	3	4
5	Karriera, aftësimi për jetën	1	1	1
6	Matematika	3	3	4
7	Kimia	2	2	-
	Fizika	2	2	-
	Biologjia	2	2	-
	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	2	-	-
	Shkenca natyrore			2
8	Qytetaria	2	1	-
	Historia	1	2	2
	Gjeografia	-	1	2
	Ekonomia	-	-	2
9	TIK	2	1	-
	Teknologjia	-	-	2
	Shuma	26	23	24
	Numri i orëve javore gjithsej	30-32	30-32	30-32

b) Kurrikula me zgjedhje të detyruar

Nr.	Fushat	Avancim dhe lëndë me zgjedhje	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Gjithsej
1	Artet (muzikë, vallëzimi, teatri, arti pamor)	-	-	-	-	-
2	Edukim Fizik dhe sporte	-	-	-	2	-
3	Gjuha e huaj	Gjuha e huaj e dytë	2	2	2	6
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	Letërsi	2	2	1	5
5	Karriera, aftësimi për jetën	-	-	-	-	-
6	Matematika	Matematikë	2	2	1	5
7	Shkenca natyrore	Kimia	-	{2}	2	4
		Fizika	-	{2}	2	4
		Biologjia	-	{2}	2	4
8	Shkenca shoqërore	Trashëgimia kulturore	{2}	{2}	-	4
		Sociologji	-	{2}	-	2
		Psikologji	-	{2}	-	2
		Historia	-	2	2	4
		Gjeografia	-	-	2	2
		Ekonomia	-	-	2	2
		Filozofi	-	-	{2}	2
9	Teknologjia	TIK	1	1	1	3
		Teknologjia	-	-	2	2

Shënim

Simboli () tregon se lënda mund të zhvillohet edhe në vitin pasardhës

Simboli { } tregon se lënda mund të zhvillohet në vitin para dhe pasardhës

Në përfundim të gjimnazit, nxënësi duhet të këtë kryer:

- Shërbim komunitar 18 orë
- Projekt kurrikular në nivel shkolle ose grup klasash 18 orë
- Modul profesional 36 orë.

GJIMNAZI ME KOHË TË SHKURTUAR

Nr.	Avancim dhe lëndë me zgjedhje	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII	Klasa XIII
1	Gjuhë e huaj e parë	2	2	2	-
2	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	2	3
3	Karriera, aftësimi për jetën	-	1	1	-
4	Matematikë	2	2	2	3
5	Kimi	2	1	1	-
6	Fizikë	2	1	1	2
7	Biologji	2	1	1	-
8	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	2	-	-	-
	Hyrje në filozofi	-	-	-	2
	Qytetari	-	2	1	-
9	Histori	-	1	2	2
10	Gjeografi	-	1	1	2
11	TIK	-	1	1	-
	Shuma e orëve javore	14	15	15	14

PLANI MËSIMOR I GJIMNAZIT ME ORIENTIM GJUHËSOR

Nr.	Lëndët	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII
1	Arte (muzikë, vallëzim, teatër, art pamor)	-	2	-
2	Edukim fizik dhe sporte	1	1	1
3	Gjuhë e huaj I	4	4	4
	Gjuhë e huaj II	4	4	4
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3	3	4
5	Karriera, aftësimi për jetën	-	1	1
6	Matematika	3	3	3
7	Kimi	2	-	-
	Fizikë	2	-	-
	Biologji	2	-	-
8	Qytetaria	2	1	-
	Historia	1	2	2
	Gjeografia	-	1	2
	Ekonomia	-	-	2
9	Tik	2	1	1
	Shuma	26	23	23
	% e kurrikulës bërthamë	86%	76%	76%
10	Kurrikula me zgjedhje (e detyruar)	3	6	6
11	% e kurrikulës me zgjedhje	14%	24%	24%
12	Kurrikula në bazë shkolle	2	2	2
13	Shuma e orëve javore	31	31	32

KURRIKULA ME ZGJEDHJE (TË DETYRUAR)

Nr.	Avancim dhe lëndë me zgjedhje	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII	Gjithsej
1	Gjuhë e huaj e parë ose e dytë (avancim)	2	2	2	6
2	Gjuhë e huaj e tretë	-	3	3	6
3	Letërsi	1	1	1	3
4	Matematika	1	1	1	3
5	Kimi	-	1	1	2
6	Fizikë	-	1	1	2
7	Biologji	-	1	1	2
8	Trashëgimia jonë kulturore	1	1	1	3
	Sociologji	-	2	-	2
	Psikologji	-	2	-	2
9	Historia	-	2	-	2
10	Gjeografia	-	-	2	2
11	Ekonomia	-	-	2	2
12	Filozofi	-	-	2	2
13	Tik	1	-	-	1

KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE

Nr.	Fushat	Module lëndore dhe profesionale	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII
1	Arte	Fotografi - fotoshop	1 orë	1 orë	1 orë
2	Fizikulturë dhe sporte	Lojëra sportive	1 orë	1 orë	1 orë
3	Gjuhë e huaj	Përkthim	1 orë	1 orë	1 orë
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	-			
5	Karriera aftësimi për jetën	Guidë turistike/sekretari	1 orë	1 orë	1 orë
6	Matematika	-			
7	Shkenca natyrore	Ndryshimet klimaterike	1 orë	1 orë	1 orë
8	Projektet shkollore		1 orë	1 orë	1 orë

Cikli 9-vjeçar i Shkollës koreografike

Nr.	Lëndët Mësimore	Orët javore / vjetore					
		Klasa IV	Klasa V	Klasa VI	Klasa VII	Klasa VIII	Klasa IX
A.	Kultura e përgjithshme	19	20	23	26	26	27
1	Gjuhë amtare	5	5	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2	3	3
3	Gjuhë e huaj (e dytë)	-	-	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Matematike	4	4	4	4	4	4
5	Dituri natyre	3	2	-	-	-	-
6	Fizikë	-	-	1	2	2	2
7	Kimi	-	-	-	1	1	2
8	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	2	2	2	2
9	Vendlindja	-	2	-	-	-	-
10	Histori	1	-	2	2	2	2
11	Gjeografi	-	-	2	2	2	2
12	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1
13	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	-
14	Edukimi muzikor (Solfezh)	1	2	2	2	2	2
15	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	-	-

16	Informatikë	-	-	-	1	1	1
17	Edukimi dhe këshillimi në karrierë	-	-	-	-	-	1
B	Kultura profesionale	10	12	13	15	17	19
1	Mjeshtëri kërcimi klasik	10	10	10	10	10	10
2	Ushtrime te kërcimit shqiptar	-	-	-	2	2	2
3	Valle popullore shqiptare	-	2	2	2	2	2
4	Folklor koreografik	-	-	-	-	2	2
5	Piano sekondare	-	-	1	1	1	1
6	Repertor skenik	-	-	-	-	-	2
Gjithsej A + B		29	32	36-38	41-43	43-45	46-48

Ciklit 9-vjeçar i shkollave artistike

Nr.	Lëndët	Orët javore / vjetore								
		Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IV	Klasa V	Klasa VI	Klasa VII	Klasa VIII	Klasa IX
A.	Kultura e përgjithshme	19	19	21	22	22	25	27	27	28
1.	Gjuhë amtare	8	8	6	5	5	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	-	-	2	2	2	2	2	3	3
3	Gjuhë e huaj (e dytë)	-	-	-	-	-	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
5	Dituri natyre	-	-	2	3	2	-	-	-	-
6	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
7	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
8	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
9	Vendlindje	-	-	-	-	2	-	-	-	-
10	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
11	Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
12	Edukatë Shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
13	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	1
14	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
15	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
16	Informatikë	-	-	-	-	-	-	1	1	1
17	Edukimi dhe këshillimi në karrierë	-	-	-	-	-	-	-	-	1
17	Veprimtari jashtëkurrikulare e lëndë me zgjedhje	1	1	1	2	2	2	1	1	1
B	Kultura profesionale	4	4	4	4	4	4	5	5	5
1	Instrumenti	2	2	2	2	2	2	2	2	2
2	Solfezh	2	2	2	2	2	2	2	2	2
3	Instrument sekondar	-	-	-	-	-	-	1	1	1
Gjithsej A + B		23	23	25	26	26	29-31	32-34	32-34	33-35

Shkollat Artistike

DEGA: MUZIKË (3-vjeçare)

Specialitetet: Piano, Violinë, Violonçel, Violë, Vegla të frymës, Perkusion, Kitarë

Nr	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore		
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	18	14	14
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	3
2	Gjuhë e huaj	3	3	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	3	2	2
5	Fizikë	2	-	-
6	Kimi	2	-	-

7	Biologji (Anatomi dhe fiziologji e njeriut)	2	-	-
8	Qytetari	2	-	-
9	Histori	-	1	2
10	Gjeografi	-	1	2
11	Teknologji informacioni dhe komunikimi	1	1	1
12	Edukim në karrierë dhe aftësim për jetën	-	1	1
13	Edukim Fizik	1	1	1
14	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Ekonomi, Filozofi, Sociologji, Psikologji)	-	2	-
B.	Lëndët teorike-artistike	5	5	3
1	Histori muzike		3 (2+1)	3 (2+1)
2	Estetikë arti		2	-
3	Folklor muzikor		-	-
C.	Lëndët praktike - artistike		16	18
1	Harmoni		3 (2+1)	3 (2+1)
2	Analizë muzikore e veprave		3 (2+1)	3 (2+1)
3	Teori solfezhi		2	2
4	Orkestër		2	2
5	Muzikë dhome/ansambël		2	2
6	Orkestracion		-	2 (1+1)
7	Instrument sekondar		1	-
8	Instrument/specialitet		3	3
9	Lexim partiture		-	1
Gjithsej A + B + C		35-35	35 - 37	35 - 37

DEGA: KOREOGRAFI (3-vjeçare)
Specialiteti: Kërcimtar

Nr.	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore		
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	15	15	13
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	3
2	Gjuhë e huaj	3	3	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	3	2	2
5	Fizikë	2	-	-
6	Kimi	2	-	-
7	Biologji (Anatomi dhe fiziologji e njeriut)	-	2	-
8	Qytetari	2	-	-
9	Histori	-	1	2
10	Gjeografi	-	1	2
11	Teknologji informacioni dhe komunikimi	1	1	1
12	Edukim në karrierë dhe aftësim për jetën	-	1	1
13	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Ekonomi, Filozofi, Sociologji, Psikologji)	-	2	-
B.	Lëndët teorike - artistike	2	2	5
1	Histori baleti	-	1	2
2	Histori muzike	2 (1 + 1)	2 (1+1)	-
3	Estetikë arti	-	-	2
C	Lëndët praktike - artistike	22	23	22
1	Ushtrime të karakterit botëror	2	2	2
2	Kërcim historik	-	2	2
3	Valle popullore	2	2	2
4	Duet klasik	2	2	2
5	Balet modern	2	2	2
6	Folklor koreografik	2	-	-
7	Repertor skenik	2	2	2
8	Mjeshtëri kërcimi	10	10	10
9	Mjeshtëri aktori	-	1	1
Gjithsej A+ B+C		39-41	40-42	40-42

DEGA: MUZIKË (4-vjeçare)

Specialitetet: Fizarmonikë, Korno, Trombë, Trombon, Perkusion, Fagot, Kitarë dhe Kanto

Nr.	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore			
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	19	14	7	8
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	1	3
2	Gjuhë e huaj	3	2	2	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	2	2	1	2
5	Fizikë	2	-	-	-
6	Kimi	2	-	-	-
7	Biologji (Anatomi dhe fiziologji e njeriut)	2	-	-	-
8	Qytetari	2	-	-	-
9	Histori	1	2	-	-
10	Gjeografi	1	2	-	-
11	Teknologji informacioni dhe komunikimi	1	1	1	-
12	Edukim në karrierë dhe aftësim për jetën	-	-	1	1
13	Edukim fizik	1	1	1	-
14	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Ekonomi, Filozofi, Sociologji, Psikologji)	-	2	-	-
B.	Lëndët teorike - artistike	-	5	5	3
1	Histori muzike	-	3 (2+1)	3 (2+1)	3 (2+1)
2	Estetikë arti	-	2	-	-
3	Folklor muzikor	-	-	2	-
C	Lëndët raktike - artistike	11	12	18	19
1	Analizë muzikore e veprave	-	-	3(2+1)	3(2+1)
2	Teori solfezhi	5	4	4	3
3	Harmoni	-	-	3 (2+1)	3 (2+1)
4	Orkestër/Kor	2	2	2	2
5	Muzikë dhome/ansambël	-	2	2	2
6	Orkestracion	-	-	-	2(1+1)
7	Instrument sekondar	1	1	1	-
8	Instrument /Specialitet	3	3	3	3
9	Lexim partiture	-	-	-	1
Gjithsej A+ B+C		30 -32	31 - 32	30 -32	30-32

DEGA: ART FIGURATIV – SKULPTURË (4-vjeçare)

Specialiteti: Qeramikë, Gdhendje guri dhe druri

Nr.	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore			
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	16 orë	14 orë	7 orë	7 orë
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	1	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	2	2	1	2
5	Fizikë	2	-	-	-
6	Kimi	2	-	-	-
7	Qytetari	2	-	-	-
8	Histori	1	2	-	-
9	Gjeografi	1	2	-	-
11	Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	-
12	Edukim në karrierë dhe aftësim për jetën	-	-	1	1
13	Edukim fizik	1	1	1	-
14	Lëndë me zgjedhje të detyruar	-	2	-	-
B.	Lëndët teorike - artistike	-	4	2	2
1	Histori arti	-	2	2	2

2	Estetikë arti	-	2	-	-
C	Lëndët praktike - artistike	17	18	24	24
1	Anatomi artistike	-	-	2	-
2	Vizatim	8	8	8	8
3	Pikturë	4	-	-	-
4	Skulpturë	-	6	8	8
5	Plastikë	4	-	-	-
6	Perspektivë	1	-	-	-
7	Specialitet	-	4	6	8
Gjithsej A+ B+C		33-35	36-38	33-35	33-35

DEGA: ART FIGURATIV – PIKTURË (4-vjeçare)
Specialiteti: Grafikë, Skenografi, Qelq, Tekstil, Fotografi artistike

Nr.	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore			
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	16	12	10	7
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	1	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
3	Matematikë	2	2	1	2
4	Fizikë	2	-	-	-
5	Kimi	2	-	-	-
6	Qytetari	2	-	-	-
7	Histori	1	2	-	-
8	Gjeografi	1	2	-	-
11	Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	-
12	Edukim në karrierë dhe aftësim për jetën	-	-	1	1
13	Edukim fizik	1	1	1	-
14	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Ekonomi, Filozofi, Sociologji, Psikologji)	-	-	2	-
B.	Lëndët teorike - artistike	-	4	2	2
1	Histori arti	-	2	2	2
2	Estetikë arti	-	2	-	-
C.	Lëndët praktike - artistike	17	20	24	24
1	Anatomi artistike	-	-	2	-
2	Vizatim	8	8	8	8
3	Pikturë	4	6	8	8
4	Plastikë	4	-	-	-
5	Perspektivë	1	-	-	-
6	Specialitet	-	4	6	8
Gjithsej A+ B+C		31-33	34-36	36-38	35-37

SHKOLLAT SPORTIVE

Nr.	Lëndët mësimore	Orët javore/vjetore			
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Kultura e përgjithshme	16	11	10	9
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	1	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Matematikë	2	2	1	2
5	Fizikë	2	-	-	-
6	Kimi	2	-	-	-
7	Biologji	2	-	-	-
8	Qytetari	-	1	1	-

9	Histori	1	2	-	-
10	Gjeografi	-	1	2	-
11	TIK	1	1	1	-
12	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	2	-	-	-
13	Edukimi në karrierë dhe aftësim për jetën	-	-	1	1
14	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Ekonomi, Filozofi, Sociologji, Psikologji)	-	-	1	2
B.	Lëndët Profesionale	17	21	23	21
1	Anatomi dhe higjienë sportive	-	2	2	-
2	Fiziologji sportive	-	-	1	1
3	Biomekanikë	-	-	-	1
4	Metodologji sportive	-	-	1	1
5	Psikologji sportive	-	-	1	-
6	Formimi teorik profesional	1	1	1	1
7	Formimi praktik profesional	13	15	15	16
8	Sporte ndihmëse 1	2	2	1	1
9	Sporte ndihmëse 2	1	1	1	1
Gjithsej A+B		33-35	32-34	33-35	30-32

Praktikat profesionale:

Praktika dimërore: Dy javë (janar - shkurt)

Praktika verore: Dy javë (gusht – shtator) para fillimit të vitit të ri shkollor

Arsimi Profesional (Struktura 2 + 1 + 1 = 4 vite)

Drejtimet: Mekanikë, Elektroteknikë, Elektronikë, Hoteleri-Turizëm, Teknologji ushqimore, Përpunim druri, Bujqësi, Peshkim, Termohidraulikë, Ndërtim etj.

Nr.	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
		Niveli I		Niveli II	Niveli III
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e kulturës së përgjithshme	15/17	11/13	8/10	15/17
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Qytetari	2	-	-	-
5	Histori	1	1	-	2
6	Gjeografi	-	-	-	2
7	Matematikë	2	1	2	2
8	Fizikë	2	1	-	-
9	Kimi	1	2	-	-
10	Biologji	-	-	-	2
11	Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	1
12	Edukim fizik	2	1	-	-
13	Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14	Aftësi për jetën	-	-	1	-
15	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti)	-	-	-	2
B.	Lëndët profesionale	10	8	7	9
1					
2					
C.	Module të detyruara të praktikës profesionale	5	10	12	6
1					

2					
D.	Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar	1	2	3	-
1					
2					
		31/33	31/33	30/32	30/32

PROVIMET

Në përfundim të Nivelit I (të parë) 2-vjeçar, nxënësit do të japin:

- 1.Provimin Përfundimtar të Teorisë Profesionale të Integruar
- 2.Provimin Përfundimtar të Praktikës Profesionale të Integruar.

Në përfundim të Nivelit II (të dytë) 1-vjeçar, nxënësit do të japin:

- 1.Provimin Përfundimtar të Teorisë Profesionale të Integruar
- 2.Provimin Përfundimtar të Praktikës Profesionale të Integruar.

Drejtimi TIK (Struktura 2 + 2 =4 vite)

Nr.	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
		Niveli I		Niveli III	
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e përgjithshme	15/17	13/15	9/11	13/15
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Qytetari	2	-	-	-
5	Histori	1	2	1	-
6	Gjeografi	-	-	-	2
7	Matematikë	2	1	2	2
8	Fizikë	2	1	-	-
9	Kimi	1	2	-	-
10	Biologji	-	-	2	1
11	Edukim fizik	2	1	-	-
12	Edukimi për karrierën	-	1	-	-
13	Aftësi për jetën	-	1	-	-
14	Histori arti	-	-	-	2
15	Shkenca e tokës	1	1	-	-
16	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	-	-	2
B.	Lëndët profesionale	10	8	9	8
1					
2					
C.	Module të detyruara të praktikës profesionale	5	7	9	7
1					
2					
D.	Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar	1	2	3	2
1					
2					
		31/33	30/32	30/32	30/32

Drejtimet: “Ekonomi/Biznes” dhe “Pyje” (Struktura 2 + 2 =4 vite)

Nr.	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
		Niveli I		Niveli III	
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.	Lëndët e përgjithshme	15/17	13/15	10/12	14/16
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3	Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4	Qytetari	2	-	-	-
5	Histori	1	2	1	-
6	Gjeografi	-	-	-	2
7	Matematikë	2	1	2	2
8	Fizikë	2	1	-	-
9	Kimi	1	2	-	-
10	Biologji	-	-	2	1
11	Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	1
12	Edukim fizik	2	1	-	-
13	Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14	Aftësi për jetën	-	1	-	-
15	Histori arti	-	-	-	2
16	Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	-	-	2
B.	Lëndët profesionale	10	8	8	10
1					
2					
C.	Module të detyruara të praktikës profesionale	5	7	9	6
1					
2					
D.	Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar	1	2	3	-
1					
2					
		31/33	30/32	30/32	30/32

PROVIMET

Në përfundim të Nivelit I (të parë) 2-vjeçar, nxënësit do të japin:

1. Provimin e Formimit të Teorisë Profesionale
2. Provimin e Formimit të Praktikës Profesionale.

Drejtimi: Veterinari (Struktura 4 vite në bllok)

Nr.	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme	15/17	11/13	12/14	14/16
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2		Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-	-	-
5		Histori	1	1	2	-
6		Gjeografi	-	-	-	2
7		Matematikë	2	1	2	2
8		Fizikë	2	1	-	-
9		Kimi	1	2	-	-
10		Biologji	-	-	2	1
11		Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	1

12		Edukim fizik	2	1	-	-
13		Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14		Aftësi për jetën	-	-	1	-
15		Histori arti	-	-	-	2
16		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	-	-	2
B.		Lëndët profesionale	9	11	8	9
1						
2						
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale	5	7	9	6
1						
2						
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar				
1			1	2	2	2
2						
Gjithsej A + B + C + D			30/32	31/33	31/33	31/33

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 9.9.2011
Doli nga shtypi më 10.9.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë